



[Rreth Nesh](#)
[Shërbime](#)
[Informacion](#)
[Projekte](#)
[Të dhëna shkencore](#)

[Programi i Transparencës](#)
[Kontakt](#)



## Drejtoritë

Lajmet

Aktivitet

Publikime

Njoftime

## Shërbimet online të AKBN



## Partnerët

## Informacion për gjëndjen aktuale të marrëveshjeve hidrokarbure

Një nga drejtimet e rëndesishme të punës së Drejtorisë së Hidrokarbureve, është ndjekja e zbatimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure për kërkimin e naftës dhe gazit në det dhe në tokë. Aktualisht janë në fuqi dy Marrëveshje Hidrokarbure, ose Kontrata me Ndarje Prodhimi (KNP), për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në blloqet e kërkimit në Shqipëri:

- Marrëveshja për Bllokun 2-3, në tokë me kompaninë Shell Upstream Albania;
- Marrëveshja për Bllokun 4, në tokë, po me Shell Upstream Albania, për të cilën pritet ratifikimi në Këshillin e Ministrave;

Janë në procesin e mbylljes tre Marrëveshje Hidrokarbure:

- 1- Marrëveshja për Bllokun Joni-5, në det me Capricorn Albania (Cairn Energy);
- 2- Marrëveshja për Blloqet 2, 3 dhe 4, në det me Emanuelle Adriatic Energy Limited;
- 3- Marrëveshja për Bllokun e Durrësit, në det;

Më poshtë po paraqesim në mënyrë të përmbledhur disa të dhëna rreth marrëveshjeve që janë aktive:

## Adrian Bylyku



Drejtor Ekzekutiv i AKBN

Regjistrohuni në letërnjoftimin

Qeveria Shqiptare,  
Këshilli i Ministrave

Ministria e  
Infrastrukturës dhe  
Energjisë

Qendra Kombëtare e  
Biznesit

Shërbimi Gjeologjik  
Shqiptar

Ministria e Turizmit dhe  
Mjedisit

Agjencia për Eficiencën  
e Energjisë

Agjencia e Menaxhimit  
të Burimeve Ujore

### 1- Marrëveshja për blloqet 2- 3 në tokë

Marrëveshja për Blloqet 2-3 është miratuar nga Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr. 754, datë 08.07.2009 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr.116, datë 31.07.2009. Interesat e pjesëmarrjes në këtë kontratë janë 100% të Royal Dutch Shell. Operator është Shell Upstream Albania.

Kompania ka përfunduar dy fazat e para të kërkimit dhe ka deklaruar më datë 4 Nëntor, 2013 se ka realizuar zbulim naftë. Rezultatet pozitive u njoftuan pas testit të kryer në pusin Shpirag-2. Këto rezultate vërtetuan që pusi Shpirag-2 prodhon naftë dhe gaz në nivelin e 1,500 deri 2,200 bbls/ditë. Nafta është e cilësisë së mirë, pra është e lehtë (35<sup>0</sup> deri 37<sup>0</sup> API) dhe përmbajtja e H<sub>2</sub>S (5,000 ppm), më e ulët nga niveli që pritej. Ky zbulim materializoi përpjekjet e mëdha të kompanive që kanë operuar prej vitesh në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë ka hapur një perspektivë reale për kërkimet e mëtejshme.

Në kuadër të kësaj marrëveshje kompania Shell ka paraqitur një Plan-Vlerësimi i cili ka si objektiv të provojë komercialitetin e pusit Shpiragu-2. Plani i Vlerësimit ka si qëllim të përcaktojë:

Naftëdhënien;

Madhësinë e rezervuarit;

Stabilitetin ekonomik të projektit;

Në kuadër të Fazës së Vlerësimit, është duke u shpuar Pusi i Vlerësimit Shpiragu-4. Në puset Molishti-1 dhe Shpiragu-3, për arsye teknike, janë pezulluar përkohësisht operacionet e shpimit, për t'iu rikthyer atyre më vonë, për përmbushjen e detyrave të tyre gjeologjike.

tonë

Email \*

Regjistrohuni

Platforma e  
Bashkëqeverisjes:



PLATFORMA E  
BASHKËQEVERISJES

0800 0118



**KOORDINATORI  
ANTIKORRUPSION**

Kompania ka realizuar një volum punimesh sizmike 2D prej 550 km, ka kryer ripërpunim të 150 km të sizmikës ekzistuese 2D, si dhe ka kryer punime të sizmikës pasive në blloqet 2 dhe 3.

Përveç shpimit të pusit Shpiragu-4, gjatë vitit 2018 kompania do të realizojë 90 km punime të reja sizmike 2D, në pjesën veriore të strukturës së Shpiragut, për të orientuar shpimin e puseve të rinj në të ardhmen.

#### 2- Marrëveshja për bllokun 4 në tokë

Gjithashtu pas negociatave të zhvilluara përgjatë një periudhe jo të shkurtër, AKBN ka mbyllur marrëveshjen me kompaninë Shell Upstera Albania për Bllokun 4 në tokë. Marrëveshja e arritur është nënshkruar nga palët dhe është përcjellë për aprovim në Këshillin e Ministrave.

#### Njoftime

Takimi shpjegues për direktivat e BE-së për...

16, 03, 2023

Njoftim për aplikim për Bllokun 5, në...

17, 10, 2022

Akreditohet Laboratori Fizikokimik i Mineraleve në Agjencinë...

22, 09, 2022

AKBN partnere zyrtare në Konferencën Ndërkombëtare "...

08, 07, 2022

Njoftim për aplikim për Bllokun Panaja, në...

10, 05, 2022

## Faqet

---

Galeria

Kontakt

Lesgjislacioni

Misioni

Partnerët

Projekte

Shqipëria që duam

## Postime te Ndryshme

---

Njoftim për vend të lirë pune

Takimi shpjegues për direktivat e BE-së për kapitujt 15 për "Energjinë" dhe 21 për

"Rrjetin European të Energjisë" në zyrat e BE në Bruksel